



Scopus®



ScienceDirect

Universiteti i Prishtinës ka abonim në Elsevier, përmes të cilit stafit akademik dhe studentëve u mundësohet anëtarësia dhe qasja në librari elektronike të punimeve shkencore. Anëtarësia në Elsevier mundëson qasje në produktet e kompanisë, si **ScienceDirect**.

ScienceDirect është portal i revistave dhe artikujve shkencorë. Ky udhëzues paraqet hapat për sigurimin e qasjes së individualizuar me përkatësinë e Universitetit të Prishtinës.

Në **ScienceDirect** mund të qaseni në dy mënyra: qasje përmes IP-së së universitetit (IP Access) ose qasje në distancë (Remote Access). Kjoqja e parë duhet të bëhet përmes rrjetit të Universitetit të Prishtinës (një pajisje elektronike që ka qasje në internet të mundësuar nga UP-ja me IP: 185.67.178.*)

Qasja me IP të Universitetit të Prishtinës (IP Access)

- Fillimisht duhet të shkoni në website-in e **ScienceDirect**-it: <https://www.sciencedirect.com/>

The screenshot shows the ScienceDirect website search interface. At the top, there is a navigation bar with the ScienceDirect logo, 'Journals & Books', 'Register', 'Sign in >', and a help icon. On the right, the University of Prishtine logo and name are displayed. Below the navigation bar, there is a search prompt: 'Search for peer-reviewed journals, articles, book chapters and open access content.' There are four input fields: 'Keywords', 'Author name', 'Journal/book title', and 'Volume'. Below these are 'Issue' and 'Pages' fields, followed by a search button with a magnifying glass icon and the text 'Advanced search'.


Logo e **Universitetit të Prishtinës** në pjesën e sipërme djathtas tregon se qasja është bërë nga IP e universitetit. Tashmë mund të vazhdohet me regjistrimin në platformë.

- Prekeni **Sign in** dhe në faqen që paraqitet krijojeni një llogari të re përdoruesi (Create an account).

The screenshot shows the ScienceDirect sign-in page. It is divided into two main sections. The left section is titled 'Sign in' and has a 'Create an account' link. It contains input fields for 'Email / Username' and 'Password', a 'Remember me' checkbox, and a 'Forgotten username or password?' link. A 'Sign in >' button is at the bottom. The right section is titled 'Sign in via your institution' and has two options: 'OpenAthens' and 'Other institution', each with a right-pointing arrow.




- Shkruajeni emrin, mbiemrin, emailin institucional (@uni-pr.edu) dhe fjalëkalimin. Nëse të dhënat janë të sakta, prekeni **Create**. Do t'ju paraqitet faqja si më poshtë:



Tashmë është krijuar llogaria personale me përkatësinë institucionale të **Universitetit të Prishtinës**.

- Në emailin tuaj do të vijë një porosi nga **ScienceDirect** me të cilën vërtetohet e drejta e qasjes në platformat e kërkimit: ScienceDirect Scopus, Mendeley, Evise, Elsevier Editorial System, SciVal, SciVal Funding, Engineering Village, Geofacets, Embase, ClinicalKey, PharmaPendium, Pathway Studio.



Në **ScienceDirect** keni qasje me përkatësinë institucionale të **Universitetit të Prishtinës** dhe me llogarinë personale. Mund të bëni kërkime dhe të shkarkoni artikuj që i përmban kontrata e abonimit në Elsevier.



Qasje në distancë (Remote Access)

Pasi të jeni kyqur në [ScienceDirect](#) me IP të universitetit dhe e keni hapur llogarinë personale, mund të qaseni edhe në distancë jashtë rrjetit universitetit. Remote Access ju mundëson të kyqeni në llogarinë tuaj në pajisje të ndryshme elektronike.

- Në pjesën e poshtme të website-it kërkoni për [Remote Access](#) dhe prekeni.



- Për të pasur qasje nga distanca, duhet ta shkruani emailin me të cilin e keni hapur llogarinë tuaj.

Apply for remote access


(*required fields)

E-mail Address: *

- Pasi sistemi ta identifikojë emailin tuaj, ju kërkohet ta shkruani fjalëkalimin. Për aktivizimin e qasjes në distancë, duket ta prekni vegzën në emailin e konfirmimit që ju është dërguar.



Pas konfirmimit të aktivizimit, ju mund të keni qasje të plotë në [ScienceDirect](#) përmes llogarisë suaj personale të lidhur me përkatësinë institucionale të [Universitetit të Prishtinës](#).



Për hollësi dhe udhëzime të mëtejshme mund të shkruani në zkps@uni-pr.edu.

Kërkim të suksesshëm!